

JUP KASTRATI

VIJAT E PËRGJITHSHME TË ZHVILLIMIT HISTORIK TË DREJTSHKRIMIT TË SHQIPES

«Rregullat e drejtshkrimit të shqipes», që u botuan më 1967, u përshëndetën, me të drejtë, si një ngjarje e shënuar në jetën tonë kulturore, në lëvizjen mendore shqiptare. Ato plotësuan një kërkesë të ngutëshme të shkollës, të shtypit dhe të letërsisë¹. Ideja themelore që përshkon projektin, është ajo që njësimi i gjuhës letrare t'i shërbejë fuqimisht njësimin të kombit tonë socialist dhe zhvillimit të tij të mëtejshëm politiko-shoqëror e kultural. Në këtë vepër ruhet e zhvillohet më tej tradita drejtshkrimore kombëtare, çdo zgjidhje e drejtë që i ka shërbyer njësimin të shqipes letrare². Puna e kryer nga ana e Komisionit hartues, duhet lavdëruar si një kontribut i shquar në detyrën e madhe, të rëndësishme dhe të ndërlikuar të normimit dhe të njësimin të gjuhës sonë. Botimi i librit mund të përfillet si frut dhe kurorëzim i përpjekjeve të parreshtura të bëra në këtë fushë, që prej kohësh. Këto «Rregulla» janë përfundim logjik i zhvillimit të gjuhës sonë të shkruar, i evolucionit të drejtshkrimit të shqipes, i procesit të njësimin të saj.

Fillimi i përcaktimit të drejtshkrimit të gjuhës sonë nis që në shekullin XVI, me autorët e letërsisë së vjetër. Megjithëqë jo në trajtë të një shkolle zyrtare, do të ketë pasur në Shqipëri, që përpara shekullit XVII, një traditë drejtshkrimore dhe, mbase, edhe një gjuhë të përbashkët, së paku, në shkrimet e përdorimit praktik³. Shkrimtarët tanë të vjetër të veriut kanë pasur një drejtshkrim të kohës, të cilin e kanë mbajtur, relativisht, mirë ndër veprat e tyre. Ndonëse kanë qenë prej krahinash të ndryshme, gjuha e punimeve të tyre na tregon një lloj koinéje në shkrim. Prirja e njësimin na çfaqet edhe në punë të drejtshkrimit; kjo ortografi, me gjithë karakterin konservativ që ka çdo drejtshkrim, paraqitet, jo vetëm e afërt me shqiptimin e kohës, po edhe mjaft e stabilizuar, dhe e zbatuar në mënyrë konsekuente⁴. Historikisht, i pari studjes i drejtshkrimit të shqipes, është F. M. da Lecce, i cili, në vitin 1716, në gramatikën e vet, përfshiu edhe një kapitull me titull: *Vërejtje rreth drejtshkrimit*

1) M. Domi, *Ngjarje e shënuar në jetën tonë kulturore*, «Mësuesi», 24.II.1967.

2) A. Kostallari, *Një hap i ri përpara në njësimin e shqipes letrare*, «Zëri i Popullit», 19.III.1967.

3) G. Petrotta, *I testi biblici*, prefazione, f. VII, «Revista indo-greco-italica» e Ribezzo-s, XVI-XVII (1932-1933).

4) E. Çabej, *Gjon Buzuku*, «Buletin për shkencat shoqërore», 2(1955) 71.

të gjuhës shqipe⁵. Brenda 14 faqesh, autori, duke ndjekur rendin alfabetik të tingujve të shqipes, është orvatur të japë disa veçori kryesore të tyre, në vokalizëm dhe konsonantizëm. Kuptohet që është larg së qeni një rregullore ortografike e mirëfillët.

Themelet e drejtshkrimit të sotëm u hodhën në shekullin XIX, gjatë periudhës së Rilindjes, kur zu të dalë problemi i gjuhës letrare dhe nisi një punë e vetëdijshme dhe e shumanshme për ngritjen e shqipes në shkallën e një gjuhe të zhvilluar kulture, për formimin e një gjuhe letrare të përpunuar, të stabilizuar e sa më të njësuar⁶. Veqilharxhi mund të konsiderohet si pararendës i shkrimtarëve dhe i gjuhëtarëve, që u përpoqën; që herët, për të afruar të dy dialektet e shqipes, në të shkruar. Në mjedisin arbëresh, Kamarda është i pari dijetar, në historinë e albanistikës, që u muar, në veçanti, me çështjet e drejtshkrimit dhe të gjuhës letrare. Dhe këto i trajtoi me gjithë seriozitetin e duhur, pavarësisht nga kriteret që ndoqi. Ai kërkoi me të drejtë «një gjuhë të përsosur e të përbashkët për të gjithë kombin», po metoda e tij qe e gabuar. Në amalgamën gjuhësore dështoi. Ai që bëri një punë të madhe përgatitore për drejtshkrimin e njësuar të shqipes, është Kristoforidhi, i cili hodhi themele të sigurta për krijimin e një gjuhe letrare të njësuar, dhe zgjoi interesin shkencor të shkrimtarëve e të gjuhëtarëve shqiptarë si edhe të dijetarëve të huaj për një problem të tillë kaq të rëndësishëm. Nga vitet 1866-67, filloi të verë, përsëri, në përdorim, për variantin verior, drejtshkrimin e vjetër të Budit dhe të Bogdanit. Në veprat e veta, ai përdori një drejtshkrim mjaft konvencional, në të cilin parimi fonetik gërshetohet me parimin historik-etimologjik. Ka shumë të ngjarë, që drejtshkrimi i veprave të tij, të ketë ushtruar, një farë ndikimi, jo vetëm mbi shkrimtarët toskë, por edhe mbi shkrimtarët gegë, në fillim të shekullit XX⁸. Në shkrimet shqipe të rilindasve vihen re përpjekje të shumta për një drejtshkrim të normalizuar, me luhatje sa më të pakta. Në këtë drejtim, Naimi luajti një rol të mirë. Përsa i takon drejtshkrimit, ai u mbështet në parimin fonetik, të pranuar nga botuesit e «Alfabetares» së Stambollit (1879). «Shoqëria e të shtypurit shkronja shqip» i vuri vetes si detyrë «të ngjallturit e gjuhës shqip e të bashkuarit të dialekteve të saj». Në njëzet vitet e fundit të shekullit XIX, Samiu bëri një punë të madhe për përcaktimin e drejtshkrimit të shqipes. Normat e drejtshkrimit që përdor, ai i mori, kryesisht, nga Kristoforidhi, e i vendosi në gramatikën që botoi për shkollat, duke i ndjekur vetë i pari besnikërisht. Ai dha ndihmesën më të rëndësishme, gjatë Rilindjes, për normalizimin e drejtshkrimit të toskërishtes letrare⁹.

5) F. M. da Lecce, *Osservazioni grammaticali nella lingua albanese*, Roma, 1716, f. 207-221: Osservazioni utilissime del P. Lecce Riformato. Parte II. Circa l'ortografia della lingua albanese.

6) M. Domi, *Rregullat e drejtshkrimit të shqipes*, «Drita», 23.IV.67.

7) D. Camarda, *Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Livorno 1864, f. 8: Cenni sulla lingua e sui diversi dialetti albanici. — D. Camarda, *Appendice al Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Prato, 1866, fq. VIII: Discorso preliminare. — D. Camarda, *A Dora d'Istria, gli Albanesi*, Livorno, 1870, fq. 49. — Dora D'Istria, *Fyletija e Arbënore prej Kanëkatë të Lao-shima*, 1867.

8) Sh. Demiraj, *Historia e gjuhës së shkruar shqipe*, Prishtinë, 1970, fq. 61.

9) USHT, *Historia e letërsisë shqipe*, II, 291, Tiranë, 1960.

Përpyekjet më të para, për trajtimin e çështjeve të veçanta të drejtshkrimit të shqipes, në gjuhën amëtare, i gjejmë nga fundi i shekullit të kaluar, në të përkohëshmen «Albania», që dilte në Bruksel dhe në Londër, gjatë periudhës 1897-1909. Aty, në një varg artikujsh, u shqyrtuan probleme të drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Revista tërhoqi vëmendjen e dijetarëve të kohës për çështjet e alfabetit dhe të drejtshkrimit, për fiksimin e një drejtshkrimi shqip, për çështjet e gjuhës letrare të përbashkët, për shkrirjen e dialekteve, etj. Me rëndësi është fakti që u ftuan lexues dhe bashkëpunëtorë të ndryshëm të organit për të çfaqur mendimet e tyre rreth krijimit të një drejtshkrimi të njësuar për të dy variantet dialektore të shqipes.

Ndër shkrimtarët e Rilindjes, që shkruan gegërisht, përpjekjet për drejtshkrimin e njësuar, si themel i një gjuhe letrare kombëtare, i ndeshim, së pari, te Zef Jubani (Ndokilia), i cili shkruan një gjuhë me prirje afrimi, nga ana fonetike, jo vetëm me gegërishten jugore, po edhe me toskërishten. Edhe Pashko Vasa ka një prirje të tillë afrimi me dialektin jugor, së pari, nga fonetika e tij e shqipes, së bashku me alfabetin që adoptoi, ndihmoi shumë në stabilizimin e disa normave drejtshkrimore¹⁰. Po ai që ka luajtur një rol me rëndësi, në këtë drejtim, është Ndre Mjeda. Në vitin 1902, ishte për të «fatur një drejtshkrim të përbashkët dhe të përgjithshëm»¹¹. Nën ndikimin e drejt-përdrejtë të Kristoforidhit, siç shkruan edhe vetë, ai përpunoi një sistem që «është i vlefshëm për njësimin e gegërishtes me toskërishten, duke ua bërë gegëvet më të lehtë të lexuarit e shkrimeve toskërisht dhe anasjelltas, duke lehtësuar, kështu, marrëdhënjet midis dy krahanave» (Gegërisë dhe Toskërisë — J. K.). Duke folur për rëndësinë e tingullit ë, Mjeda thekson: «Një ndër ndryshimet kryesore, në mes të gegërishtes dhe të toskërishtes, është, padyshim, përdorimi i zanores së shurdhët ë; teksa ndër toskët dëgjohet shumë, në gegërishten, përkundrazi, o nuk dëgjohet fare ose porsa merret me mend. Prandaj, një nga vështirësitë më të mëdha që një toskë gjen në të lexuarit e shkrimeve gege, është zhdukja e këtij shenji. Për këtë arsye... është mirë të shënohet». Lidhur me vlerën fonetike dhe fonologjike të togjeve bashkëtingëllorë *nd, mb, ng*, Mjedja thotë shprehimisht këto: «Në pikëpamje etimologjike dhe të bashkimit të dialekteve të ndryshëm, është e nevojshme të shkruhen *nd, mb*». Duke përfunduar parashkrimin e vet, gjuhëtari ynë theksonte se ky sistem «nuk është vetëm i arësyeshëm, por edhe shkencor dhe i vlefshëm për t'u përdorë për njësimin e gjuhës shqipe». Gramatologu Gaspër Jakova Mërturi, në broshurën *Ortografia e gjuhës shqipe*, botuar më 1902, e shpreh në mënyrë të prerë mendimin e vet: «Nevoja e një ortografie unike dhe e përgjithshme për të gjithë shqiptarët është e qartë. Përderisa një ortografi unike dhe e përgjithshme të mos jetë stabilizuar për të tërë Shqipërinë, çdo përpjekje për të qytetëruar vendin tonë, dhe për të përhapur arësimin, do të jetë më pak ose aspak fryt». Autori i bën thirrje

10) P. W. *Grammaire albanaise à l'usage de ceux qui désirent apprendre cette langue sans l'aide d'un maître*, London, 1887, fq. 5. — *L'alphabet latin appliqué à la langue albanaise*, 1878.

11) *Esposizione dell'alfabeto adottato nella Conferenza dei Vescovi albanesi in Scutari*, 1902. — J. Kastrati, *Katër punime të panjohura të Ndre Mjedës*, «Gjuha, letërsia dhe historia në shkollë», Tiranë, 1966, f. 143-165.

elementit intelektual dhe të kulturuar shqiptar që të gjykojë me arësye «duke sakrifikuar ambicjet për dashurinë ndaj Atdheut. Vetëm duke rrahur këtë rrugë, do të arrijmë të kemi një ortografi unike për gjuhën shqipe»¹².

Gjatë Rilindjes kombëtare, ndër shkrimtarët e Veriut, më shumë se bashkëkohësit e tij, ai që bëri punën më të madhe për afrimin ndër-dialektor, qe Luigj Gurakuqi. Ai pat arritur në përfundim se drejtshkrimi është premisë e domosdoshme për krijimin e gjuhës kombëtare të njësuar. Në artikullin *Themelimi i gjuhës letrare*, botuar më 1905, Gurakuqi shprehet kështu në lidhje me drejtshkrimin e shqipes, me rolin dhe funksionin e tij: «Ortografia ka një rëndësi të madhe fort për themelimin të një gjuhe letrare shqipe, sa mund të thomi se nuk do të arrijmë kurrë këtu, po të mos zgjedhim e po të mos caktojmë një mënyrë të posaçme e të veçantë për të shkruar një fjalë si toskërisht, si gegërisht». Në historinë e prozodisë shqiptare, Gurakuqi është i pari që u muar me studimin e zanores ë, që është një nga pikat më nevralgjike të ortografisë shqipe. Vërejtjet e tij janë interesante dhe me vlerë. Ato kanë rëndësi si për metrikën shqipe, për të cilën u shkruan, ashtu edhe për drejtshkrimin e gjuhës sonë. Studimi për këtë çështje mbështetet në fonetikën, në gjuhën e gjallë, duke u shikuar problemi në tërësinë e tij. Ai vëren se fonema ë «krijon shumë ndryshime ndërmjet gegërishtes e toskërishtes dhe të nëndialekteve të tyre, si në fushë të fonetikës, si të ortografisë. Rëndësia fonetike e ë-së së pazëshme është e madhe e, pra, nevoja e të shkruarit të saj... Si për arësye etimologjike, si fonetike, përdorimi i saj është, pra, i nevojshëm; vetëm duhet ta rregullojmë mirë që t'i apim njësi e qëndrim ortografisë shqipe»¹³. Siç shihet, Gurakuqi qe për stabilizimin e disa trajtave drejtshkrimore të shqipes dhe për njësimin e varianteve dialektore.

Drejtshkrimin të njësuar i kanë ndihmuar shumë, në fillim të shekullit tonë, edhe punimet e artikujt me karakter gjuhësor, botuar nga F. Konica, A. Xanoni, M. Duçi, A. Xhuvani, J. Vruho, M. Logoreci, K. Kamsi dhe, sidomos studimet gjuhësore të Gjergj Pekmezit. Krijimi i shoqërive kulturore «Bashkimi» (1899) dhe «Agimi» (1901) në Shkodër bënë që çështjet e drejtshkrimin të shqipes të diskutohen paralelisht edhe me problemet e alfabetit. Një ndër shërbimet më të mëdha, që iu bë popullit shqiptar, ka qenë padyshim, adoptimi i alfabetit në Kongresin e Manastirit (1908). Ky kuvend vuri, jo vetëm një bazë të përbashkët për shenja të tingujve të gjuhës sonë por, në të njëjtën kohë, hodhi edhe themelet e një drejtshkrimi të gjithmbarshëm në Shqipëri.

Gjatë periudhës njëvjeçare, shtator 1916-shtator 1917, veprimi në Shkodër Komisioni letrare shqipe, në kohën kur ishte drejtor i arësimit L. Gurakuqi. Në Komisionin pjesë disa nga gjuhëtarët dhe shkrimtarët më të mirë të kohës. Ajo përcaktoi drejt parimin themelor të drejtshkrimin të shqipes. Në nenin e parë thuhet, se «Ortografia e gjuhës

12) D. G. Yakova, *Ortografia della lingua albanese*, Venezia, Tipografia Sortani e Vidotti, 1902.

13) Lek Gruda, *Themelimi i gjuhës letrare*, «Albania», IX, 2, 47, London, 1905. — *Vargënimi n'gjuhë shqipe*, Napoli, 1906, fq. 79.

do të jetë fonetike, d.m.th. gjuha do të shkruhet ashtu si flitet sot prej popullit»¹⁴. Ky parim i drejtshkrimit është një parim demokratik i gjuhës letrare dhe do të thotë që gjuha letrare shqipe buron drejtpërdrejt nga gjuha e popullit. Komisija bëri një punë të vlefshme dhe me baza të shëndosha historiko-shkencore¹⁵. Siç shënohet edhe në parathënje të broshurës, Komisija u përpoq «qi t'i japë një trajtë të përbashkme e të thjeshtë mënyrës së shkrimit të gjuhës. Broshura *Rregulla mbi orthografin e gjuhës shqipe të shkrueme* është kodifikimi i parë i drejtshkrimit tonë. Vendimet e Komissisë letrare, të miratuara më vonë nga Kongresi arësimor i Lushnjës (1920), shërbyen si bazë themelore për drejtshkrimin e shqipes deri në çlirimin e Shqipërisë. Këto vendime e lehtësuan mjaft zgjidhjen e problemit të drejtshkrimit, por nuk e zgjidhën këtë problem¹⁶. Rregullat e Komissisë patën një rëndësi të veçantë për njësimin e shqipes së shkruar. Mirëpo s'vonoi shumë dhe ndonjë nga anëtarët e Komissisë letrare u ngrit kundër «Rregullave të ortografisë», që kishte pëlqyer dhe nënshkruar vetë. Kështu, p.sh. Ambroz Marlaskaj, në artikullin *Mbi ortografi të sotshme*, shprehte mendimin që rregullat e drejtshkrimit të shqipes «padyshim kanë nevojë të merren në dorë përsëri»¹⁷. Në të gjitha vërejtjet e Marlaskajt nxjerr krye partikularizmi në gjuhë, tendenca lokaliste. Që këtu fillon në Shkodër edhe e ashtuquajtura «shkollë ortografike françeskane». Në kundërshtim me këtë, në krye të dhjetë vjetëve të Komissisë letrare, krijohet, po në këtë qytet, e ashtuquajtura «shkollë ortografike jezuite».

Më 1927, botohet libri *Ortografia shqype*¹⁸, pa emër autori. Po ajo dihet, nga burime të tjera bibliografike, se është hartuar prej jezuitit italian Adon Aldeghierit¹⁹, për nxënësit e Kolegjit saverian. Autori, në mjaft vise, puqet me vendimet e Komissisë letrare, sidomos për togjet e zanoreve *ue, ye, ie*, si edhe, pjesërisht, për grupet e bashkëtingëlloreve *mb, nd, ngj* dhe për zanoren *ë*; por në shumë vende bie erë shkodranishteje. Nga kjo anë, autori bën një hap prapa, përsa i takon kristalizimit të gjuhës së njësuar.

Gjatë periudhës së pavarësisë, një varg gjuhëtarësh, arësimtarësh, publicistësh dhe shkrimtarësh dhanë një kontribut të mirë për mjaft çështje të ortografisë shqipe, duke botuar artikuj në shtypin periodik të kohës për probleme të ndryshme të drejtshkrimit të shqipes. Punimet e tyre shprehin interesat gjuhësore dhe dëshirat e intelektualëve përparimtarë për një drejtshkrim të njësuar; ato pasqyrojnë, njëkohësisht, edhe nivelin apo gjendjen e studimeve gjuhësore të kohës. Është detyrë e shkencës sonë të ré të gjuhësisë shqiptare që të kuj-

14) *Rregulla mbi orthografin e gjuhës shqipe të shkrueme*, të vendosuna, prej Komissisë Letrare, Shkodër, 1917, Shtypshkronja Franciskane, 8 f.

15) E. Lafe, *Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe*, «Mësuesi», 7.VI.1972.

16) A. Kostallari, *art. cit.*

17) A. Marlaskaj, *Mbi ortografi të sotshme*, «Hylli i Dritës», III, 2, 70, Shkodër, shkurt 1922.

18) Tubë librash për shkollë gjimnazike, tregtare e fillore botue prej Etënve jezuit. Blëni XXIX. *Ortografia shqype*, Shkodër, Shtypshkronja e së Papërlyemes, 1927, f. 64.

19) Rev. «Leka», XV, 6, 203, Shkodër, qershor 1943: Nomenclator.

tojë me respekt punën e këtyre levruesve të shqipes, që punuan për stabilizimin, normativizimin dhe kodifikimin e ortografisë sonë. Kështu, mund të përmendim artikujt e shkruar, për këtë qëllim, nga A. Xhuvani, P. Bardhi, S. Nivica, S. Gjuka, H. Mosi, J. Minga, J. Rrota, S. Shuteriqi, Asdreni, A. Imami, O. Myderrizi, Gj. Ujka, H. Stërmilli, etj. Do të ishte me shumë interes për historinë e studimeve ortografike të shqipes, po të ndiqej polemika gjuhësore për drejtshkrimin e shqipes, në vitet '20-'30. Këtu do të dilnin në pah edhe divergjencat, drejtimet, kriteret, parimet dhe rrugët e ndjekura, ndikimet e shkollave të huaja dhe të gjuhëve të huaja, sepse «edhe në fushën e ortografisë e në atë të gjuhës letrare, në përgjithësi, është zhvilluar një luftë e vazhdueshme midis forcave përparimtare dhe forcave regresive, që pengonin ecjen përpara të procesit të njësimit të mëtejshëm»²⁰. Një gjendje kaotike gjuhësore mbizotëronte në botimet letrare dhe publicistike të atyre viteve. Artikujt e ndryshëm karakterizoheshin nga një anarki e vërtetë drejtshkrimore. Kuptimplotë është një artikull me titull *Babilonia në ortografinë shqiptare*, botuar më 7 dhjetor 1933²¹.

Në mënyrë: të veçantë, një polemikë e ashpër gjuhësore shpërtheu në shtypin periodik shqiptar të viteve 1935-1939, në mes të disa organeve, si «Illyria», «Përpyjekja shqiptare», «Cirka», «Drita», «Jeta e re», «Dielli», «Shtypi», «Java», «Leka», «Hylli i dritës», «Shkolla kombëtare», etj. Kjo polemikë gjuhësore e ndërlikoi edhe më shumë çështjen e drejtshkrimit të shqipes. Me atë rast, u shprehën mendime nga më kontradiktoret, u ndoqën dhe drejtime të ndryshme, u zbatuan parime dhe kritere që, nga ndonjëherë, ishin në kundërshtim me rrymën e zhvillimit të gjuhës sonë, sidomos me evolucionin e konvergimit ndër-dialektor të shqipes letrare.

Gjatë periudhës së pavarësisë dhe të pushtimit të huaj, gjuha shqipe pati një ortografi mjaft laramane. Rregullat e Komisionit letrare, të miratuara nga Kongresi arësivor i Lushnjës, u zbatuan në tekstet mësimore, të botuara nga Ministria e Arësimit. Shkrimtarët dhe publicistët që shkruanin toskërisht, përdornin një ortografi më vete. Në Shkodër ekzistonin dy «shkolla» ortografike: ajo e botimeve françeskane dhe jezuite. Këtyre drejtshkrimeve, në pragun e çlirimit, më 1944 erdh e iu shtua edhe ajo e ashtuquajtura ortografi e pangegërishtes letrare. Si rrjedhim, problemet e drejtshkrimit të shqipes nuk u zgjidhën. Dhe kjo, objektivisht, ishte e pamundur, në atë kohë. Njësimi i drejtshkrimit të shqipes u doli përpara, si detyrë brezave të ndërtuesve të socializmit. Kjo që një nga detyrat madhështore për krijimin e kulturës kombëtare socialiste²². Sot, Kongresi ynë historik i drejtshkrimit po kurorëzon përpjekjet e parreshtura të përfaqësuesvet më të përparuar të mendimit shkencor, arësivor e kulturor shqiptar për njësimin e drejtshkrimit të shqipes dhe të gjuhës sonë letrare kombëtare.

20) M. Domi, *art. cit.*

21) *Babilonia në ortografinë shqiptare*, «Besa», III, 723, 2 T. 7.XII.33.

22) A. Kostallari, *art. cit.*

TABLE DES MATIERES

		Page
	Le Congrès de l'Orthographe de la Langue albanaise.	3
	Résolution du Congrès de l'Orthographe de la Langue albanaise.	31
ANDROKLI KOSTALLARI	La langue littéraire albanaise contemporaine — problèmes fondamentaux de son orthographe.	39
C O M M U N I C A T I O N S		
MAHIR DOMI	Le principe phonétique dans l'orthographe de l'albanais.	89
EQREM ÇABEJ	Questions de la tradition de l'écriture et de l'orthographe de l'albanais.	97
IDRIZ AJETI	Le chemin du développement de la langue littéraire albanaise dans la Kosove.	109
REMZI NESIMI	L'allure de l'unification de l'orthographe de l'albanais littéraire dans la Macédoine.	119
ANASTAS DODI	L'orthographe et l'orthoépie.	123
JORGJI GJINARI	La langue littéraire, l'orthographe et les dialectes de l'albanais.	131
JANI THOMAJ	Sur les limites du mot en albanais et questions d'orthographe.	137
BAHRI BECI	Sur principe historique traditionnel dans l'orthographe de l'albanais.	155
EMIL LAFE	L'orthographe et la graphie de l'albanais.	161
MUNIR RESO	Questions de la langue littéraire nationale albanaise et de sa norme.	165
DHIMITËR S. SHUTERIQI	Les hommes de lettres et l'orthographe.	171
REXHEP QOSJA	Les hommes de lettres et la langue littéraire.	175
KOÇO BIHIKU	Le concours de la littérature artistiques à stabiliser la norme littéraire et à perfectionner notre langue.	181
NIKOLETA CIKULI	Le rôle de la presse dans la fixation et diffusion de la norme orthographique.	187
BEDRI DEDJA	De l'accélération psychique et son influence dans l'enseignement de la langue littéraire.	193
JUP KASTRATI	Les lignes générales du développement historique de l'orthographe de l'albanais.	201

СО Д Е Р Ж А Н И Е

		стр.
	Съезд правописания албанского языка	3
	Резолюция съезда правописания албанского языка	31
АНДРОКЛИ КОСТАЛЛАРИ	Современный албанский литературный язык и некоторые основные проблемы его правописания.	39
С С О Б Щ Е Н И Я		
МАХИР ДОМИ	Фонетический принцип албанского правописания.	89
ЭКРЕМ ЧАБЕИ	О некоторых вопросах традиции албанского письма и правописания.	97
ИДРИЗ АЕТИ	Путь развития албанского литературного языка в Косове.	109
РЕМЗИ НЕСИМИ	Процесс унификации правописания албанского литературного языка в Македонии.	119
АНАСТАС ДОДИ	Правописание и литературное произношение.	123
ИОРГИ ГЬИОНАРИ	Литературный язык, правописание и албанские диалекты.	131
ЯНИ ФОМАИ	О границах слова в албанском языке и некоторые вопросы правописания.	137
БАХРИ БЕЦИ	О традиционно-историческом принципе в правописании албанского языка.	155
ЭМИЛЬ ЛЯФЕ	Правописание и графика албанского языка.	161
МУНИР РЕСО	Некоторые вопросы национально албанского литературного языка и его нормы.	165
ДИМИТРИ ШУТЕРИКЬИ	Писатель и правописание.	171
РЕДЖЕП КЬЕСЯ	Писатели и литературный язык.	175
КОЧО БИХИКУ	О некоторых задачах художественной литературы для кристаллизации литературной нормы и дальнейшей обработки родного языка.	181
НИКОЛЕТА ЦИКУЛИ	Роль печати в установлении и распространении орфографической нормы.	187
БЕДРИ ДЕДЬЯ	О психической акселерации и её влиянии над усвоением литературного языка.	193
ЮП КАСТРАТИ	Главные линии исторического развития правописания албанского языка.	201

NDREQJE GABIMESH

Faqja	Rreshti	Është shtypur	Duhet
41	7	popujeve	popujve
44	25	objektivës	objektives
»	»	subjektivës	subjektives
»	27	objktive	objektive
»	1 i shënimit	Cincronia	Sinkronia
67	20	vitest	vitet
77	15	bashkëveprojën	bashkëveprojnë
90	25	besnik	fisnik
»	36	në	me
»	49	është	asht
137	11	e te formimi	e të formimit
»	10 i shën.	i nyjeve	e nyjeve
»	27 i shën.	në trajtë	një trajtë
140	19 i shën.	по тенция	ПОТЕНЦИЯ
»	21 i shën.	наука	НАУКИ
141	18 »	oise-aux-mouches	oiseaux-mouches
»	20 »	coud-de-pied	couds-de-pied
144	14	të cilët	të cilat
145	19	organizatË	organizatE
147	12 i shën.	лесотундра	ЛЕСОТУНДРА
»	21 »	Z.A. Potika	Z.A. Potiha
148	2 »	fjalësha me ndajshtim	janë togfjalësha me ndajshtim
150	3 »	филологически	ФИЛОЛОГИЧЕСКИЕ
188	38	4.593.600	45.936.000
157	30	nuk janë sporadike	nuk janë të shpeshta
158	18	me përdorimin	në përdorimin
160	6	fitojnë	fitojmë
190	21	poshtërues, fitues	poshtërus, fituës

Shënim: Në faqen 187 në rrjeshtin e dytë të lexohet «... por një problem që ka të bëjë me të gjithë; këtu qëndron edhe rëndësia e këtij Kongresi i cili do të përcaktojë...»

Çmimi Lekë 5